



Republika e Kosovës Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Municipality Dragas



Në bazë të nenit 58 pika h të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/15, Qershor 2008), dhe nenit 21 të Ligjit Nr. 6/L-092 për Dhënjën në Shfrytëzimin dhe Shkëmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunale dhe në bazë të nenit 24, 25 të Rregullores (VRK) nr. 09/2020 për thellimin e procedurave për shfrytëzimin dhe këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, neni 56 i Statutit të Komunës së Dragashit, 01 nr.06-103/1 së datës 11.09.2008. Kryetari i Komunës së Dragashit i propozon Kuvendit të Komunës së Dragashit, Kuvendi i Komunës në Dragash në mbledhjen e mbajtur me datën 15.09.2023 pas shqyrtimit dhe votimit paraprak, miraton këtë:

VENDIM

I. Për dhënjën në shfrytëzimin e pronës së paluajtshme komunale, për raste të veçanta, për një periudhë deri në 99 vjet, për nevojat e Postës së Kosovës.

II. Njësia (ngastra) kadastrale e cila jepet në përdorim ka këto karakteristika:

a) Njësia kadastrale (ngastra):

P-706040006-01326-2, Zona kadastrale Bresanë, Sipërfaqja e përgjithshme 130m², në vendin e quajtur „BRODOSAN-BRODOSAN“,

Sipërfaqja e cila jepet për shfrytëzim Postës së Kosovës është 130m².

b) Lloji i përdorimit:

Tokë ndërtimi/oborr

c) Pronari/poseduesi: PronshoqërORE

1. PASURI SHOQERORE (-BASHKESIA LOKALE)

III. Përcaktohet një kompensim prej 12 € në vit, të cilin detyrohet t'ia paguajë Komunës, me kohë që kompensimi të jetë i vlefshëm deri në shitjen e parë të mundshme të aksioneve të kompanisë ose privatizimit të kompanisë, për të cilën Komuna e Dragashit do të informohet me kohë para shitjes së aksioneve apo privatizimit të kompanisë, për të përcaktuar kompensimin real për shfrytëzimin e sipërfaqes së caktuar për qëllimin e përcaktuar në Kërkesë.

IV. Në bazë të këtij vendimi, autorizohet Kryetari i komunës që të fillojë procedura të mëtutjeshme në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe të lidhë kontratë me përfaqësuesin e autorizuar rrethë shfrytëzimin e pronës së paluajtshme komunale, kundrejt tarifës, me elementet dhe të dhënat nga pika 1 dhe 2 e këtij vendimi. Kryetari i komunës është i autorizuar të përcaktojë qartë në Marrëveshje të gjitha klauzolat e nevojshme kontraktuale, të cilat janë të nevojshme, dhe detajet që nuk janë të parapara në këtë Vendim, por që kërkohen nga legjislacioni aktual. Fillimi i pagesës së kompensimit përcaktohet nga Kryetari i Komunës, ndërsa shumën e kompensimit, në rast të shitjes eventuale të aksioneve apo privatizimit, çmimi do të përcaktohet nga ekspertët apo institucionet kompetente financiare.

V. Pjesë përbërëse e këtij propozim vendimi janë:

- a) certifikatën e njësisë kadastrale, br.952-1347/23 od 05.09.2023.
- b) ortofoto nga vendi i ngjarjes

01 nr. 060/01-24752-4/23

Datë 15.09.2023



Kryesuesi i Kuvendit
Uran Ballini